



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 138, Datë 21.05.2026

MBI

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 342, DATË 23.12.2025 “MBI FILLIMIN PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET BARRËSIMIT) TË ASETVE TË PALUAJTSHME TË SAJ, SI MJET PËR GARANTIMIN E SHLYERJES SË DETYRIMIT NDAJ “RAIFFEISEN BANK” SH.A.”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 64 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 46/19 prot., datë 19.05.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosje kolateral asetet fikse të të licencuarit, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Raiffeisen Bank sha”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.09.2022.
- Me shkresën nr. 2627/2 prot., datë 03.12.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit për vendosje kolateral të asetve fikse, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 342, datë 23.12.2025, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.
- Pas analizimit/vlerësimit të dokumentacionit të përcjellë, bordi i ERE-s me **vendimin nr. 67, datë 02.03.2026**, vendosi të përfundojë procedurën e nisur me vendimin nr. 342/2025, në lidhje me kontratat e kredive të nënshkruara para licencimit (në datat 19.04.2021, 13.10.2021 dhe 24.08.2022) si dhe të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për kontratën e kredisë nr. 7316 rep., nr. 3097 kol., datë 02.09.2025.
- Në vijim, bordi i ERE-s me **vendimin nr. 95, datë 02.04.2026**, vendosi të zgjasë deri në 60 ditë afatin e vendimmarrjes përfundimtare të këtij aplikimi, ku shoqëria/banka duhet të depozitonin brenda 40 ditëve dokumentacionin e munguar.
- Së fundi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 46/18 prot., datë 18.05.2026, shoqëria ka njoftuar se ka vendosur të ristrukturojë kreditë për të cilat ka paraqitur më parë aplikimin në ERE, ndaj ka kërkuar pezullim të procedurës administrative të nisur dhe pas përfundimit të

procesit të ristrukturimit të kredive, do të paraqesë një aplikim të ri pranë ERE-s sipas dokumentacionit dhe kushteve përkatëse.

- Neni 64, pika 2 i ligjit 45/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se, një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative.
- Për gjithë sa më sipër, referuar kërkesës së shoqërisë, vlerësojmë se jemi në rrethanat e përfundimit të procedurës së nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 342, datë 23.12.2025, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit për vendosje kolaterali mbi asetet fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 342, datë 23.12.2025 “Mbi fillimin procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimi) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI